



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
KESHILLI BASHKIAK

Nr 390 prot

Ballsh, më 03 07 2026

VENDIM

Nr 37 Datë 30 / 06 / 2026

PËR MIRATIMIN FINANCIMIT PËR 4 (KATËR) FAMILJE NË PROGRAMIN E STREHIMIT SOCIAL, FOND I MIRATUAR ME VKB NR.51 DATË 23.12.2025 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026, DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2026-2026 DHE NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE".

Keshilli bashkik në mbledhjen e tij të dates 30.06.2026 pasi u njoh me relacionin për. Për miratimin financimit për 4 (katër) familje në programin e strehimit social, fond i miratuar me vkb nr.51 datë 23.12.2025 "për miratimin e buxhetit të vitit 2026, dokumentit përfundimtar të projekt buxhetit afatmesëm 2026-2026 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve". Mbështetur në nenet 34,40,41, 55 të ligjit Nr 139/2015 "Për Vetqeverisjen vendore", ligjin Nr 9936 datë 26-08-2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore", Ligjin Nr 87/2025 "Për Buxhetin e Vitit 2026", ligjin Nr 10296 date 08-07-2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", vendimit të Këshillit Bashkiak nr.51 datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026, dokumentit përfundimtar të projekt buxhetit afatmesëm 2026-2026 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve", Këshilli Bashkiak Mallakastër:

VENDOSI:

1. Të miratoj fondin e bashkëfinancimit nga të ardhurat e veta të Bashkisë në shumën 3.912.550 lekë për 4 famije të cilat i bashkangjiten listës fituese për projektin "Përmirësim i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara 2026" sipas tabelës së mëposhtëme :
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Mallakastër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

NEXHMI SUTAJ

